



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
Kuvendi

PROJEKTLIGJ

Nr. \_\_\_\_\_/2022

PËR

**TITUJT E NDERIT DHE TITUJT VENDORË TË NDERIT NË  
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

**V E N D O S I:**

**KREU I  
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1  
Objekti**

Objekt i këtij ligji është përcaktimi i llojeve të titujve të nderit dhe titujve vendorë të nderit, që jepen në Republikën e Shqipërisë, si dhe rregullave, procedurave dhe kritereve për propozimin, shqyrtimin dhe dhënien e titujve nga institucionet përgjegjëse.

**Neni 2  
Qëllimi**

Ky ligj ka për qëllim krijimin dhe organizimin e titujve të nderit dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë, që jepen si shenjë nderimi ndaj shtetasve shqiptarë apo të huaj për veprimtari dhe kontribut të dalluar në fusha të

ndryshme, për mbrojtjen dhe promovimin e interesave të shtetit, kombit shqiptar apo komuniteteve të njësive të vetëqeverisjes vendore.

### **Neni 3**

#### **Parime të përgjithshme**

1. Dhënia e titullit të nderit ose titullit vendor të nderit në Republikën e Shqipërisë udhëhiqet nga parimi i nderimit publik dhe i vlerësimit të kontributit.

2. Përfitimi i një titulli nderi ose titulli vendor nderi nuk është një e drejtë dhe nuk mund të kërkohet si e tillë, në rrugë individuale ose institucionale.

3. Dhënia e titullit të nderit ose titullit vendor të nderit nuk shoqërohet me shpërblim financiar.

### **Neni 4**

#### **Subjektet përfitues**

Titujt e nderit dhe titujt vendorë të nderit që parashikohen në këtë ligj mund t'i jepen shtetasve shqiptarë ose të huaj, që janë dalluar në kryerjen e veprimtarive të fushave të ndryshme, brenda ose jashtë vendit, për mbrojtjen dhe promovimin e interesave të shtetit, kombit shqiptar apo komunitetit të njësive të vetëqeverisjes vendore.

## **KREU II**

### **TITUJT E NDERIT**

### **Neni 5**

#### **Llojet e titujve të nderit**

Titujt e nderit në Republikën e Shqipërisë jepen nga Presidenti i Republikës dhe janë:

- a) Titulli Ambasador i kombit;
- b) Titulli Qytetar nderi i Republikës së Shqipërisë.

### **Neni 6**

#### **Titulli Ambasador i kombit**

Titulli Ambasador i kombit i jepet shtetasve shqiptarë ose pjesëtarëve të diasporës, në shenjë mirënjohje për veprimtari, kontribute dhe merita të spikatura e të qëndrueshme, që lartësojnë vlerën dhe figurën e kombit shqiptar.

### **Neni 7**

#### **Titulli Qytetar nderi i Republikës së Shqipërisë**

Titulli Qytetar nderi i Republikës së Shqipërisë i jepet shtetasve të huaj në shenjë mirënjohje për veprimtari, kontribute dhe merita të spikatura në shërbim të kombit e shtetit shqiptar dhe të forcimit të shoqërisë demokratike, brenda dhe jashtë vendit.

### **KREU III TITUJT VENDORË TË NDERIT**

#### **Neni 8 Llojet e titujve vendorë të nderit**

Titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë janë titulli Qytetar Nderi dhe tituj të veçantë vendorë nderi që jepen sipas përcaktimeve të këtij ligji.

#### **Neni 9 Titulli Qytetar nderi**

1. Titulli Qytetar nderi jepet nga këshilli bashkiak për veprimtari të shquar brenda juridiksionit dhe në dobi të bashkisë ose për veprimtari për mbrojtjen dhe promovimin e interesave të komunitetit brenda territorit të bashkisë.

2. Titulli Qytetar nderi i jepet në çdo rast edhe personaliteteve të huaja të nivelit të lartë që vizitojnë një bashki në kuadër të një vizite zyrtare ose shtetërore.

#### **Neni 10 Titujt e veçantë vendorë të nderit**

1. Njësia e vetëqeverisjes vendore ka të drejtë të krijojë dhe të japë jo më shumë se 2 (dy) tituj të veçantë vendorë nderi në një vit kalendarik, për të shprehur mirënjohjen e posaçme për veprimtarinë e shquar në dobi të komunitetit të saj.

2. Titujt e veçantë vendorë të nderit krijohen me vendim të njësisë së vetëqeverisjes vendore, i cili përmban:

- a) nevojën për nderimin e veçantë;
- b) arsyen përse nderimi me titullin qytetar nderi, sipas nenit 9 të këtij ligji, nuk është i përshtatshëm dhe i mjaftueshëm dhe shtetasi i propozuar për nderim duhet dalluar nga shtetasit e tjerë; dhe
- c) emërtesën e titullit të veçantë vendor të nderit i cili përkon me një datë ose ngjarje të shënuar në territorin e njësisë së vetëqeverisjes vendore.

### **KREU IV**

## **PROCEDURA E NDERIMIT**

### **Neni 11**

#### **E drejta e nismës dhe propozimit**

1. Nisma për dhënien e titullit të nderit ndërmerret nga Presidenti, kryesisht ose me propozimin e:
  - a) Kryetarit të Kuvendit;
  - b) Kryeministrit;
2. Propozimi për dhënien e titullit vendor të nderit paraqitet nga:
  - a) kryetari i bashkisë; ose
  - b) çdo anëtar i këshillit bashkiak.

### **Neni 12**

#### **Kërkesa për ushtrimin e nismës ose propozimit**

1. Organet e përcaktuara në nenin 11 të këtij ligji, mund t'i ushtrojnë të drejtat e tyre të nismës dhe propozimit, edhe duke u mbështetur në kërkesat e paraqitura nga shtetasit për këtë qëllim, sipas parimeve dhe kritereve të këtij ligji.
2. Çdo shtetas ka të drejtë të paraqesë kërkesën për ushtrimin e të drejtës së nismës ose propozimit, për një shtetas të caktuar, në një nga institucionet që kanë këtë të drejtë, sipas nenit 11. Në këtë rast, kërkesa duhet të arsyetojë edhe shkaqet për të cilat shtetasi kërkon ushtrimin e të drejtës së nismës ose propozimit. Kërkesa nuk mund të paraqitet për nderimin e vetvetes.
3. Institucioni pranë të cilit është paraqitur kërkesa për ushtrimin e të drejtës së nismës ose propozimit, pas shqyrtimit të saj vendos për pranimin ose refuzimin e kërkesës.

### **Neni 13**

#### **Propozimi për nderim**

1. Institucionet që kanë të drejtën e propozimit, paraqesin propozimin për nderim pranë institucionit përgjegjës për dhënien e titullit përkatës jo më vonë se 90 (nëntëdhjetë) ditë kalendarike përpara datës së propozuar për dhënien e titullit, me përjashtim të rasteve kur, sipas rrethanave të çështjes, nuk është i mundur zbatimi i këtij afati.
2. Propozimi për nderim përmban:
  - a) institucionin propozues;
  - b) bazën ligjore për propozimin,
  - c) të dhëna identifikuese të shtetasit të propozuar për nderim;
  - ç) lidhjen midis institucionit dhe shtetasit të propozuar për nderim;
  - d) veprimtarinë e kryer nga shtetasi i propozuar për nderim, si dhe arsyet e hollësishme për nderimin e tij;

- dh) llojin e titullit të propozuar;
  - e) informacione, shoqëruar me dokumentacionin provues, që vërtetojnë përmbushjen e kriterëve përkatëse për nderim, sipas përcaktimeve të këtij ligji;
  - ë) informacioni se shtetasi i propozuar për nderim nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale, si dhe që nuk është nën hetim ose gjykim për një vepër penale nga organet përgjegjëse;
  - f) të dhënat për dekorime ose nderime të mëparshme të shtetasit të propozuar;
  - g) çdo element tjetër të nevojshëm për verifikimin dhe plotësimin e kriterëve përkatëse për nderim.
3. Kur nisma ndërmerret kryesisht nga Presidenti, përmban informacionin dhe dokumentacionin provues të përcaktuar në shkronjat “b” deri “g”, të pikës 2 të këtij neni.

#### **Neni 14**

##### **Komisioni këshillimor**

1. Me qëllim shqyrtimin e nismave dhe propozimeve për nderim, jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë përpara datës së caktuar për nderim, Presidenti dhe njësitë vetëqeverisjes vendore ngrenë përkatësisht, komisionin këshillimor.
2. Komisioni këshillimor përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, ku 3 (tre) anëtarë janë punonjës nën varësinë e institucionit përgjegjës për dhënien e titullit dhe 2 (dy) anëtarë janë personalitete të jashtme.
3. Institucioni përgjegjës për dhënien e titullit i dërgon komisionit këshillimor për shqyrtim të gjitha nismat për nderim, të bëra kryesisht ose nga institucionet që kanë të drejtë të ushtrojnë të drejtën e propozimit.
4. Rregullat e hollësishme për kriteret, procedurat për përzgjedhjen e anëtarëve, funksionimin, si dhe mënyrën e ushtrimit të përgjegjësive të komisioneve, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

#### **Neni 15**

##### **Shqyrtimi paraprak i propozimit**

1. Brenda 5 (pesë) ditëve nga ngritja e tij, komisioni këshillimor verifikon paraprakisht nëse nisma ose propozimi për nderim është paraqitur:
  - a) nga institucionet e caktuara në nenin 11, të këtij ligji;
  - b) brenda afatit dhe përmban të gjithë elementët të përcaktuar në nenin 13, të këtij ligji;
2. Në përfundim të verifikimit paraprak, komisioni këshillimor:
  - a) vendos për vijimin e shqyrtimit të nismës ose propozimit;
  - b) i kërkon institucionit që ka ndërmarrë nismën kryesisht ose institucionit propozues, plotësimin e të metave të propozimit për nderim brenda 10 (dhjetë) ditëve, ose;

c) dërgon pranë institucionit përgjegjës për dhënien e titullit, mendimin për mospranimin e propozimit kur ai është paraqitur jashtë afatit të përcaktuar në nenin 13, të këtij ligji.

## **Neni 16**

### **Shqyrtimi i propozimit**

1. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja e vendimit për vijimin e shqyrtimit të propozimit ose nga plotësimi i të metave të tij, komisioni këshillimor shqyrton dhe dërgon mendimin për përmbushjen ose jo të kriterëve për nderim.

2. Krahas informacionit dhe dokumentacionit të paraqitur në nismën ose propozimin për nderim, komisioni kërkon informacione ose dokumentacion shtesë nga shtetasi i propozuar për nderim, si dhe nga çdo person fizik ose juridik apo organ publik vendas ose i huaj, që disponon të dhëna të vlefshme për shqyrtimin e plotë të nismës ose propozimit.

3. Çdo subjekt i përmendur në pikën 2, të këtij neni, përmbush kërkesat e komisionit për informacione dhe dokumentacion, me përjashtim të rasteve të kufizuara me ligj, brenda një afati ligjor të arsyeshëm të përcaktuar nga komisioni në kërkesën e tij.

4. Në çdo rast komisioni çmon, sipas bindjes së tij, se cilat fakte konsiderohen të provuara bazuar në parimet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji, në vlerësimin e hollësishëm të informacioneve dhe dokumentacioneve në dispozicion, si dhe në rezultatin tërësor të shqyrtimit, duke hartuar për këtë qëllim raportin përkatës.

5. Procesi i shqyrtimit të nismës ose propozimit mund të shtyhet për shkak të rrethanave të paparashikuara që dëmtojnë reputacionin dhe vlerën e aktit të nderimit në opinionin publik, deri në sqarimin e këtyre rrethanave.

## **Neni 17**

### **Mendimi i komisionit**

Në përfundim të shqyrtimit, komisioni i dërgon institucionit përgjegjës për dhënien e titullit mendimin e arsyetuar, për:

- a) miratimin e nismës ose propozimit;
- b) refuzimin e nismës ose propozimit për shkak të mosplotësimit të të metave brenda afatit 10 (dhjetë) ditor ose për shkak të mos përmbushjes së kriterëve sipas këtij ligji.

## **Neni 18**

### **Vendimmarrja mbi propozimin**

1. Miratimi ose refuzimi i propozimit bëhet me:
  - a) dekret, në rastin titujve të nderit;

- b) vendim, në rastin e titujve vendorë të nderit.
2. Në çdo rast, vendimmarrja mbi propozimin i njoftohet institucionit propozues dhe komisionit këshillimor.
3. I njëjti propozim nuk mund të bëhet pa kaluar 2 (dy) vite nga njoftimi për refuzimin e tij.

### **Neni 19**

#### **Heqja e titujve**

Heqja e titujve dhe titujve vendorë të nderit bëhet:

- a) me vendim të formës së prerë të dhënë nga gjykatat shqiptare, kur është dhënë si dënim plotësues sipas përcaktimeve në Kodin Penal;
- b) me vendim të institucionit përgjegjës për dhënien e titullit ose titullit vendor të nderit, kur mbajtësi i tij:
- i) është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale, ose
- ii) është shpallur “person i padëshiruar”, sipas përcaktimeve të legjislacionit që rregullon regjimin e hyrjes e të qëndrimit të të huajve në Republikën e Shqipërisë.

## **KREU V**

### **DISPOZITA KALIMTARE DHE TE FUNDIT**

#### **Neni 20**

##### **Aktet nënligjore**

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë aktin nënligjor në zbatim të nenit 14 pika 4, të këtij ligji.

#### **Neni 21**

##### **Dispozitë kalimtare**

1. Të gjitha titujt të dhënë përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, njihen dhe mbahen sipas motivacionit dhe kushteve me të cilat janë dhënë.
2. Heqja e tyre bëhet sipas përcaktimeve të këtij ligji.

#### **Neni 22**

##### **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**LINDITA NIKOLLA**